

PRESIONI SERB PËR ASIMILIMIN E SHQIPTARËVE ORTODOKSË (SHEK. XIX DERI NË VITIN 1913)

Fehari RAMADANI
Universiteti Shtetëror i Tetovës

Punim studimor

Përmbajtja e shkurtër: Gjatë shek. XIX te popujt e Ballkanit lindën dhe u zhvilluan lëvizjet nacionaliste. Këto lëvizje u shoqëruan me përpjekjet për pushtimin e territoreve të banuara nga popullsia e huaj, e që në atë kohë ishin ende pjesë e Perandorisë Osmane. Synimet për pushtimin e territoreve shqiptare nga ana e shteteve ballkanike, bënë që këto shtete të angazhoheshin maksimalisht për të ndryshuar strukturën etnike të territoreve të pretenduara. Në këtë kuadër, nëpërmjet kishës dhe të shkollës ato zhvilluan propagandë të dendur në tokat shqiptare. Propaganda e vendeve të Ballkanit u favorizua edhe nga qëndrimi i Portës së Lartë për të mos njohur ekzistencën e kombit shqiptar. Moslejimi i hapjes së shkollave në gjuhën shqipe, mosnjohja e pavarësisë së Kishës Ortodokse Shqiptare u bë pengesë në procesin e ndërgjegjësimit kombëtar të shqiptarëve, çka krijoi terren të përshtatshëm për realizimin e synimeve serbe për ta paraqitur popullsinë ortodokse shqiptare, të viseve të sipërme shqiptare, si popullsi serbe. Qeveria serbe fillimisht nëpërmjet kishës dhe shkollës dhe më vonë duke përdorur dhunën arriti ta serbizonte një pjesë të mirë të popullsisë shqiptare ortodokse. Secili që i takonte fesë ortodokse automatikisht konsiderohej nga ata si serb.

Fjalët çelës: kishë, ortodoks, serb, patrikana, Stambolli, shqiptar etj.

Deri në fund të ekzistencës së saj, Perandoria Osmane nuk e njohu konceptin e kombit. Ajo i identifikonte shtetasit e saj sipas përkatësisë fetare. Nga të gjitha kombet e Perandorisë, shqiptarët u dëmtuan më së shumti nga kjo politikë. Ata u takonin tri besimeve të ndryshme*. Sundimi i gjatë osman bëri që krahas dy besimeve të mëparshme ortodokse dhe katolike, një pjesë e madhe e shqiptarëve të konvertoheshin në fenë myslimane¹. Politika teokratike osmane, nënshtetasit e saj nuk i identifikonte në bazë të përkatësisë gjuhësore e kombëtare. Kështu, shqiptarët që ishin të ndarë në tri besime, qeveria osmane, sipas konceptit mesjetar, i ndante në tri milete të ndryshme (osmanlinj, rum dhe katolik-milet) dhe rrjedhimisht jeta e tyre shpirtërore drejtohej nga tri institucione fetare, arsimore dhe kulturore të huaja. Këto institucione fetare vareshin nga tri qendra universale të huaja: Kalifati sulltanor, Patrikana e Stambollit* dhe Papati, asnjëra prej të cilave nuk e përkrahte idenë e një shteti kombëtar shqiptar².

Dallimet fetare te shqiptarët u mundësuan shteteve fqinje që të zhvillonin propagandën e tyre brenda territoreve shqiptare. Secili prej tyre përpiquej që t'i përfitonte shqiptarët ortodoksë. Për grekët secili që në aspektin kishtar ishte i lidhur me Patrikanën Ekumenike ishte grek³. Të njëjtën politikë e ndoqën serbët dhe bullgarët në periudhën e mëvonshme. Politika e identifikimit të përkatësisë fetare me kombin, rriti rivalitetin midis qeverive ballkanike për të dominuar në territore të banuara nga besimtarët ortodoksë. Periudha e fundit të shek. XIX dhe fillimit të atij XX u karakterizua nga një luftë e ashpër midis kishave ortodokse

* Krahas këtyre tre grupeve kryesore fetare, një pjesë më e vogël janë bektashinj dhe protestantë.

¹ Prifti, Kristaq. 2001. Diversiteti fetar dhe uniteti kombëtar te shqiptarët. Në *Studime Historike*, nr. 1-2. Tiranë, f. 25-27.

* Gjatë shek. XIX, një pjesë e ortodoksëve të pjesës ballkanike të Perandorisë Osmane u lidhën me Patrikanën Serbe ose Ekzarkatin Bullgar, varësisht ndikimit që kishte arritur të shtrinte njëra ose tjetra në një territor të caktuar. Për rrjedhojë, besimtarët ortodoksë filluan të identifikoheshin si serbë, grekë ose bullgarë, varësisht se cilës kishë i takonin.

² Krahaso: *Historia e Popullit Shqiptar II*. 2002. Tiranë: Toena, f. 27; Frashëri, Kristo. 2006. *Identiteti kombëtar shqiptar dhe çështje të tjera*. Tiranë: EDISUD Spa, f. 129-131; Shih dhe: Roka, Maroco dela. 1994. *Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920-1944*. Tiranë: A. Z. Çajupi, f. 47, 48; Rahimi, Shukri. 1971. *Rilindja dhe emancipimi kombëtar*. Shkup: Fondi republikan për zhvillimin e veprimtarisë botuese, f. 7.

³ Jelavish, Charls dhe Barbara. 2004. *Themelimi i Shteteve Kombëtare të Ballkanit 1804-1920*. Tiranë: Dituria, f. 193.

ballkanike për të përfitur sa më shumë besimtarë, pavarësisht përkatësisë së tyre kombëtare e gjuhësore. Ashtu si Porta e Lartë edhe qeveritë dhe kishat ballkanike, për llogari të tyre i quanin besimtarët ortodoksë serbë, grekë, ose bullgarë. Për ata nuk kishe rëndësi edhe nëse këta njerëz nuk ishin të tillë për nga origjina. Mjaftonte që besimtarët të ishin të lidhur me kishën përkatëse dhe menjëherë identifikoheshin si të tillë (serbë, grekë, ose bullgarë). Madje në rastet kur ata vareshin nga një kishë tjetër, ushtrohej dhunë për t'i detyruar të hiqnin dorë nga kisha e mëparshme dhe të lidheshin me kishën e re. Fillimisht për terrorizimin e popullsisë u përdorën bandat e armatosura, të cilat përkraheshin nga qeveritë përkatëse, kurse nga viti 1912 me këtë çështje u morën ushtritë pushtuese të këtyre vendeve.

Kategorizimi që nuk merrte parasysh gjuhën e folur, të kaluarën historike, prejardhjen etj., por si elementë bazë merrej besimi fetar ishte i dëmshëm për shqiptarët. Kjo për faktin se ata që nga mesjeta u takonin disa besimeve fetare dhe politika qeveritare për t'i ndarë në tri milete të ndryshme, rrezikonte identitetin kombëtar. Për këtë arsye drejtuesit e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare kërkonin që të gjithë atyre që flisnin gjuhën shqipe, t'u njihej përkatësia etnike shqiptare.

Të vetëdijshëm se shqiptarët e besimeve të ndryshme kishin bashkëjetuar për shekuj me radhë, krahë njëri-tjetrit, kërkesë e veçantë e programit kombëtar ishte edhe njohja e të drejtave të barabarta për shqiptarët e “*të gjitha feve*”. Drejtuesit e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare e kishin të qartë se vetëm të bashkuar mund t'u bënin ballë pretendimeve shkombëtarizuese të shteteve fqinje dhe të vetë Perandorisë Osmane. Që gjatë shek. XIX të shqiptarët filloi të zinte vend gjithnjë e më shumë koncepti gjerman mbi kombin, i cili bazohej mbi themelet gjuhësore. Kështu, feja i hapi rrugë konceptit kombëtar⁴.

Që nga pushtimi osman i Kostandinopojës (1453) e deri në shek. XIX, Patrikana e Stambollit kishte pozitë të privilegjuar* ndër popullsinë ortodokse të perandorisë. Ajo ishte institucion sa fetar aq edhe arsimor dhe kulturor. Si e tillë ajo mbështeti idetë nacionaliste greke dhe i luftoi

⁴ Guy, Nicola. 2012. *Lindja e Shqipërisë*. Tiranë: Pegi, f. 16-17.

* Sipas marrëveshjes së arritur në vitin 1454, midis sulltan Mehmet Fatihut dhe patrikut të Kostandinopojës, të gjithë ortodoksët e Perandorisë Osmane konsideroheshin rum millet, që nënkuptohej se ishin bizantinë ose grekë dhe mbi ta ushtronte autoritet të pakufizuar fetar Patrikana. Katolikët trajtoheshin si pjesëtarë të latin millet, në kuptimin e besimtarëve të varur fetarisht nga Roma. (Shih më gjerësisht: Frashëri, Kristo, *vep. e përm.*, f. 131).

ato të popujve të tjerë⁵. Kështu, fillimisht rreziku kryesor për shkombëtarizimin e shqiptarëve ortodoksë vinte nga Patrikana e Stambollit, prandaj një pikë e veçantë e programit kombëtar ishte edhe njohja e autonomisë për Kishën Ortodokse Shqiptare. Patrikana e drejtuar nga grekët në vazhdimësi i kishte shërbyer politikës së qeverisë së Athinës. Nëpërmjet priftërinjve dhe mësuesve të emëruar prej saj, zhvillohej një politikë asimiluese ndër shqiptarët ortodoksë, e cila në disa raste dhe kishte pasur sukses. Për pengimin e kësaj fushate ishte e domosdoshme që komuniteti ortodoks shqiptar të shkëputej nga varësia greke.

Deri në fund të shek. XIX shqiptarët kishin luftuar kundër politikës helenizuese që zhvillonte qeveria greke nëpërmjet Patrikanës së Stambollit. Tani, atyre u duhej të përballëshin edhe me dy propaganda të tjera, atë bullgare dhe atë serbe, të cilat kishin edhe mbështetjen e Rusisë. Rrjedhimisht, nën tryshninë e Shën Petërsburgut, sulltani dhe Patrikana Ekumenike emëruan në Prizren një peshkop. Kjo shkaktoi zemërimin e atdhetarëve shqiptarë, të cilët, në emër të 300 vetave, më 1891, i dërguan një memorandum sulltanit, me të cilin i ankoheshin se përse i kishte autorizuar serbët dhe bullgarët që të ngrinin shkolla në territoret shqiptare, seminare dhe peshkopata në gjuhët e tyre. Njëkohësisht i bëhej thirrje sulltanit që t'u jepej shqiptarëve gjithashtu leja për hapjen e shkollave në gjuhën shqipe në të njëjtat territore⁶.

Ashtu si grekët që, nëpërmjet Patrikanës së Stambollit, shfrytëzuan kishat dhe shkollat për të përhapur propagandën e tyre në territoret shqiptare, të njëjtën gjë e bënë serbët gjatë shek. XIX. Kishat kishin të drejtë të hapnin shkolla në çdo dioqezë për besimtarët e tyre, në gjuhët respektive. Shpesh kjo e drejtë keqpërdorej nga klerikët, të cilët hapnin shkolla edhe në ato vendbanime ku nuk kishin besimtarë të tyre⁷. Në këtë kuadër, qeveria e Beogradit, në vitin 1836, hapi dy shkolla fillore në Prizren, kurse në vitin 1848, tashmë ekzistonin shkolla serbe në Gjakovë, Pejë, Vushtrri, Graçanicë. Sipas reformës së vitit 1856 çdo bashkësi fetare jo myslimane kishte të drejtë të hapte shkollat e veta publike, madje ato mund të financoheshin edhe nga shtetet e jashtme. Për dallim nga serbët që kishin fituar të drejtën e shkollës më herët, shteti osman

⁵ Bozbor, Nuray. 2002. *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane*. Tiranë: Dituria, f. 262.

⁶ Skendi, Stavro. 2000. *Zgjidhje kombëtar shqiptar 1878-1912*. PHOENIX & Shtëpia e librit dhe komunikimit, f. 270.

⁷ Arkivi i Institutit të Historisë në Tiranë, (Më tej: AIH), A-IV-154, Timo Dilo, Shqipëria në vitet e fundit të shek. XIX, Kap. XVI-1229-C, f. 15.

vazhdoi të mohonte të drejtën shqiptarëve për të hapur shkolla në gjuhën e tyre. Ky qëndrim i Portës së Lartë i dëmtonte shqiptarët dhe i favorizonte serbët. Serbëve të Kosovës u lejohej të themelonin edhe shoqata fetare e kulturore (Shoqata e Shën Bazilit, 1860); në vitin 1856 ata filluan ndërtimin e një kisha të re në Prizren, kushtuar Shën Gjergjit, ndërsa në vitin 1871 hapën edhe një seminar ortodoks⁸, në Prizren, të njohur si Bogoslovia, që do të përgatiste mësues-teologë serbë. Më 1890 në Prishtinë u hap një librari, e cila do të furnizonte me libra dhe mjete të tjera shkollare shkollat serbe. Pas vitit 1856, serbët në Kosovë fituan të drejtën e hapjes së shkollave publike. Prandaj, një pjesë e madhe e fëmijëve u larguan nga shkollat që funksiononin brenda manastireve dhe vazhduan t'i ndiqnin mësimet në shkollat e reja. Qeveria osmane kishte lejuar që këto shkolla të financoheshin nga jashtë (nga Serbia dhe Rusia)⁹.

Ilija Garashanin tregonte interesim të veçantë për jetën kulturore të serbëve në Kosovë, prandaj dërgoi dy mësues serbë në Prizren (1866). Në Beograd u themelua një komitet për organizimin e propagandës serbe, i cili arriti të themelonte 61 shkolla në rajonet e “*paçliruara*”, në jug të shtetit të atëhershëm serb. Në vitin 1873, një anëtar i komitetit, Millosh Millojeviqi, hapi një shkollë në Beograd për fëmijët e territoreve të “*paçliruara*”, ku çdo të diel mbaheshin fjalime dhe ligjërime të zjarrta, duke glorifikuar historinë serbe¹⁰.

Shkollat serbe në Kosovë përpos që synonin t'i shërbenin arsimit të popullsisë, ato njëkohësisht shërbenin edhe si qendra propagande për forcimin e vetëdijes kombëtare të serbëve dhe idesë për bashkim kombëtar. Në një raport që konsulli austro-hungarez në Shkup ia dërgonte Vjenës, më 22 janar 1893, theksonte se “*pothuajse të gjithë mësuesit dhe priftërinjtë serbë janë agjentë që janë vënë në shërbim të Serbisë*”¹¹. Serbët, bullgarët për të imponuar ndërgjegjen kombëtare, patën në shërbim të tyre kishat, shkollat, bandat e armatosura si dhe

⁸ Malcolm, Noel. 2001. *Kosova-një histori e shkurtër*. Prishtinë-Tiranë: Koha-Shtëpia e Librit, f. 195.

⁹ Mehmeti, Sadik. 2019. *Shkollat dhe arsimit në Kosovë 1830-1912*. Prishtinë: Instituti Albanologjik, f. 365-369; Malcolm, Noel, *vep. e përm.*, f. 195.

¹⁰ Malcolm, Noel, *vep. e përm.*, f. 196.

¹¹ Mehmeti, Sadik, *vep. e përm.*, f. 366; Braha, Shaban. 1992. *Gjenocidi serbomadh dhe qëndresa shqiptare (1844-1990)*. Tiranë: Lumi-T, f. 86.

mbështetjen e Fuqive të Mëdha, të fuqishme për t'ia imponuar vullnetin e tyre Perandorisë Osmane¹².

Politika e Beogradit për serbizimin e territoreve shqiptare, herë pas here favorizohej edhe nga qëndrimi i Portës së Lartë. Qeveria osmane vazhdonte të luftonte me çdo mjet zhvillimin e gjuhës dhe të shkollave shqipe, por në territoret shqiptare i njihte të drejtën e arsimit në gjuhën amtare pakicës serbe. Për më tepër, në gusht të vitit 1871, në Prizren filloi botimi i gazetës “*Prizren*”, organ zyrtar i Vilajetit të Prizrenit, kopertina e së cilës shtypej në osmanishte dhe në serbisht¹³. Në këto dy gjuhë do të shtypet edhe gazeta “*Kosova*” (1877)¹⁴. Të njëjtin qëndrim qeveria osmane mbante edhe në vilajetet e tjera shqiptare. Në vilajetin e Janinës, gazeta zyrtare osmane botohej në gjuhën osmane dhe atë greke¹⁵, por jo në gjuhën shqipe. Kështu shteti osman minoritetit serb dhe të tjerëve u njihte më tepër të drejta se shqiptarëve, të cilët përbënin shumicën dërrmuese të popullsisë në vilajetet e përmendura.

Në funksion të politikës së tyre, Serbia dhe Rusia hapën edhe përfaqësitë e tyre diplomatike dhe dërguan emisarë në Shkup, Prizren, Prishtinë, Mitrovicë. Më 1889 u hap konsullata serbe në Prishtinë, e cila ndihmoi në hapjen dhe financimin e shkollave serbe dhe nxiste konflikte ndërmjet serbëve lokalë dhe shqiptarëve, me qëllim destabilizimin e rajonit¹⁶, duke i paraqitur gjithmonë shqiptarë fajtorë të përleshjeve. Propaganda serbe u shtri thellë brenda territoreve osmane. Emisarët serbë, të cilët futeshin në atë zonë si agjentë të *Balkanska Banka*, kishin shpenzuar shuma të mëdha të hollash në funksion të propagandës së tyre. Ata nëpërmjet bandave të armatosura kryenin reprezalje mbi popullsinë¹⁷ shqiptare.

¹² Frashëri, Mid'hat. 2018. *Vepra të zgjedhura*, 2. Tiranë: Instituti i Studimeve Historike: Lumo Skëndo, f. 206.

¹³ Malcolm, Noel, *vep. e përm.*, f. 200.

¹⁴ Mehmeti, Sadik, *vep. e përm.*, f. 372; Eren, Ismail. 1968. Štamparija Kosovskog Vilajeta u Prištinu (1877-1888). Në *Gjurmime Albanologjike*, nr. 1. Prishtinë, f. 171-177.

¹⁵ *Haus Hof und Staats Archives*, Wien. (Më tej: HHSAW). Memorandum i Komitetit Qendror Shqiptar për Kostandinopojë për ministrin e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë. Kostandinopojë, më 28 korrik 1912.

¹⁶ Mehmeti, Sadik *vep. e përm.*, f. 368.

¹⁷ *Haus Hof und Staats Archives, Politisches Archives, Wien, Arkivi i Institutit të Historisë në Tiranë (Më tej: AIH)*. Fondi Dokumente të sjella nga Arkivi i Vjenës dhe të përkthyer në shqip, Vj. 18-4-438. Raport i Rappaport nga Shkupi për ministrin e Punëve të Jashtme, kontin Aehrenthal. Shkup, më 26 mars 1908.

Ndërsa refuzonte në vazhdimësi kërkesat e shqiptarëve për hapjen e shkollave në gjuhën shqipe, qeveria osmane u tregua shumë bujare përballë kërkesave të serbëve të Kosovës. Për të penguar fuqizimin e ndikimit bullgar në Ballkan, qeveria osmane favorizonte kërkesat serbe, me qëllim që këto dy propaganda të viheshin përballë njëra-tjetrës. Kjo politikë dëmtoi interesat e shqiptarëve dhe të vetë shtetit osman. Ambasadori serb në Stamboll, Vladan Gjorgjeviq (filloi detyrën më 1 shtator 1894), arriti të siguronte leje nga qeveria osmane për hapjen e shkollave serbe në Vilajetin e Kosovës dhe atë të Manastirit. Do të hapeshin gjimnaze në Stamboll, Shkup dhe në Selanik, kurse në Vilajetin e Kosovës ishin hapur 50 shkolla dhe të tjera do të hapeshin në atë të Manastirit¹⁸.

Synimi i gjithë kësaj ndërmarrjeje serbe në territoret shqiptare ishte serbizimi i popullsisë autoktone vendase. Asimilimi i shqiptarëve në serbë kishte filluar që në mesjetë, por vazhdoi edhe në periudhën e mëvonshme, madje edhe gjatë shek. XX¹⁹.

Që nga viti 1578, katolikët e Kosovës Lindore kalonin si në fenë myslimane ashtu edhe në atë ortodokse. Kjo ndodhte sepse ata kishin mungesë priftërinjsh dhe nuk i gëzonin privilegjet e kishës ortodokse. Në vitet 1538/39 thuhej se meqë katolikët e Trepçës nuk kishin prift, shumica e tyre kaluan në kishën serbe²⁰, për rrjedhojë në periudhën e mëvonshme ata u serbizuan.

Argjipeshkvi katolik Matia Mazareku (Mazreku), i cili kishte udhëhequr me Argjipeshkvinë e Shkupit në vitet 1758-1807, ishte serbizuar. Megjithëse e fliste shqipen, ai nuk identifikohet me shqiptarët. “*Ai paraqiste shembullin më të mirë të asimilimit nga shqiptar në sllav*”²¹. Nëse kisha serbe kishte arritur të asimilonte priftërinj katolikë, të cilët ishin nën mbrojtjen e Papatit, serbizimi i shqiptarëve ortodoksë bëhej shumë më lehtë.

Anëtarët e fisit Kuçi, të cilët jetonin brenda kufijve të Malit të Zi, e morën gjuhën sllave dhe filluan ta quajnë veten e tyre malazez. Megjithatë, në fillim të shek. XX, të 700 shtëpitë e këtij fisi ishte akoma e gjallë kujtesa që provonte se e kishin folur shqipen para shtatë brezash²². Në fakt, pjesëtarët e këtij fisi në shek. XVII ishin njohur si shqip-

¹⁸ Mehmeti, Sadik, *vep. e përm.*, f. 370, 371, 374.

¹⁹ Malcolm, Noel, *vep. e përm.*, f. 205.

²⁰ *Po aty*, f. 133.

²¹ *Po aty*, f. 178.

²² Frashëri, Mid'hat, *vep. e përm.*, f. 203.

tarë*.²³ “Duket se fisi Kuç ka qenë i tërë fis shqiptar, se edhe sot dihen 700 shtëpi në Kuç që flasin shqenisht (serbisht – F. R.), por të cilat shtatë a tetë breza më parë kanë folur shqip”²³. Pozita e favorizuar e serbëve i ndihmoi ata që të serbizonin popullsinë ortodokse në territoret shqiptare. Studiuesi N. Malcolm konstaton se 2.000 deri në 3.000 vllah ortodoksë, gradualisht u serbizuan, si pasojë e ndikimit kulturor të Kishës Ortodokse Serbe ose u larguan nga Kosova²⁴. Nëse serbët mund të asimilonin këtë grup etnik që ishte nën mbrojtjen e qeverisë rumune, pa shumë vështirësi mund të serbizonin shqiptarët ortodoksë, të cilët nuk gëzonin mbrojtjen e asnjë shteti.

Konsulli austro-hungarez, Ippen, i cili ka shërbyer në territoret shqiptare dhe njëkohësisht ishte njohës mjaft i mirë i çështjes shqiptare ka shkruar se “është e diskutueshme se në ç’masë një pjesë e fiseve malazeze nuk është vet me prejardhje shqiptare”²⁵. Fillimisht nën ndikimin e kishës, kurse më vonë edhe të shkollës, popullsia ortodokse shqiptare e viseve veriore, verilindore dhe lindore kaloi gradualisht nën sferën serbe të ndikimit. Kryerja e shërbesave fetare dhe zhvillimi i mësimin në gjuhën serbe çoi në serbizimin e kësaj popullate.

Asimilimi i shqiptarëve ortodoksë në territoret e Kosovës qe një proces i pandërprerë. Nëpërmjet ndikimit të kishës dhe të shkollës qeveria e Beogradit arriti që atyre t’ua impononte gjuhën serbe. Deri në fillim të shek. XIX fshatrat e rrethinës së Vushtrrisë “Sllatinë dhe Rasnik ishin krejtësisht shqiptare, por që atëherë u kthyen plotësisht në serbe”²⁶.

Kishat ortodokse nderoheshin edhe ndër shqiptarët e Kosovës, ndoshta për shkak të traditës së tyre fetare të mëhershme. Një udhëtar anglez, i cili vizitoi Kosovën në vitin 1850 shprehej se Manastiri i Patrikanës së Pejës “respektohej shumë nga banorët, si nga të krishterët, ashtu dhe nga myslimanët”²⁷. Në të kaluarën jo të largët një pjesë e

* Fisniku nga Kotorri, Mariano Bolica, në relacionin e tij të datës 25 maj 1614, i quan asit (Cuzzi), shqiptarë. Gjithashtu edhe vetë studiuesi serb, Jovan Cvijiq pranon se i është një fis shqiptar. (Shih: Frashëri, Mid’hat, *vep. e përm.*, f. 203).

²³ *Po aty*, f. 54. (Shih referencën 4).

²⁴ Malcolm, Noel, f. 202, 210, 211.

²⁵ Bartl, Peter. 2006. *Myslmanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare (1878-1912)*. Tiranë: Dituria, f. 67.

²⁶ Gravier, Gaston. 1911. *Vieille Serbie et les albanais*. Revue de Paris, f. 216. (Cituar sipas: Frashëri, Mid’hat, *vep. e përm.*, f. 225. Shih referencën 199, f. 224-225).

²⁷ Malcolm, Noel, *vep. e përm.*, f. 197.

shqiptarëve myslimanë kishin qenë ortodoksë, prandaj nderonin objektet fetare ortodokse.

Kisha e Shën Spasit ose Kisha e Gogut (e vllshve), në Prizren, e cila ndodhej në pjesën e vjetër të qytetit, në zonën e nënklasë, ishte ndërtuar rreth viteve 1333-1335. Ajo konsiderohet se “*nuk ishte serbe*”, por kishë shqiptare. Gjatë periudhës së sundimit osman, serbët e kishin djegur disa herë atë²⁸. Nëse kisha do të kishte qenë serbe, nuk kishte arsye që vetë serbët ta digjnin atë. Ndoshta arsyet e djegies së disahershme të saj lidheshin pikërisht me faktin se ajo nuk ishte e tyre. Megjithatë, më vonë serbët e kishin përvetësuar atë, ashtu siç kanë vepruar në vazhdimësi për të serbizuar çdo gjë ortodokse në pjesën veriore të territoreve shqiptare.

Gjatë një vizite të Mary Edith Durhamit (1863-1944), në Manastirin Ortodoks të Deviçit (në jug të Skenderajt të Drenicës), në vitin 1908, shoqëruesi shqiptar i saj, i cili e fliste vetëm pak serbishten, e pyeti arkimandritin e manastirit nëse kuptonte shqip. Në pyetjen e shoqëruesit të zonjës Durham, ai kishte qeshur dhe ishte përgjigjur: “*Unë jam shqiptar. I lindur nga prindër shqiptarë*”. Ai u kishte shpjeguar mysafirëve se “*kishte folur shqip vetëm si fëmijë. Por, pasi u bashkua me Kishën Ortodokse, ai qe tanimë një serb dhe dinte më mirë serbishten sesa gjuhën e vet amtare*”²⁹.

Asimilimi i shqiptarëve ortodoksë fillonte me burrat të cilët e mësonin gjuhën serbe dhe pastaj zgjerohej brenda familjeve. Në Vushtrri dhe në Pejë një pjesë e mirë e ortodoksëve ishin shqiptarë. Ata dalloheshin nga serbët dhe bullgarët nga disa veçori, si: zakonet e përditshme, të folurit shqip nga gratë dhe fëmijët e tyre në vatrën familjare³⁰ etj. Popullsia e qytetit të Pejës “*(rreth 50 shtëpi), e cila në vatrën e veta fliste shqip, ngatërrohej me ortodoksët serbë (gati 250 shtëpi) që flisnin serbisht në shtëpitë e tyre*”. Prandaj, shpeshherë në regjistrimet e kohës llogariteshin si sllavë. Në 25 fshatrat e Rekës (krahinë midis Gostivarit dhe Dibrës), popullsia ortodokse fliste vetëm shqip dhe e konsideronte veten si të tillë³¹. Rajoni i Rekës së Epërme ishte i banuar tërësisht nga popullsia shqiptare. Më shumë se gjysma e popullsisë ishte ortodokse.

²⁸ Ahmeti, Nuridin. 2017. Prizreni i Mitrush Kutelit. Në *Mitrush Kuteli-në 110 vjetorin e lindjes (përmbledhje materiale)*. Korçë: Universiteti Fan Noli, f. 366.

²⁹ Durham, Edith. Pa datë. *Shqipëria e Epërme-Një udhëtim në Shqipërinë e veriut të vitit 1908*. Tiranë: Botimet IDK, f. 269.

³⁰ Frashëri, Mid'hat, *vep. e përm.*, f. 195-196.

³¹ Krahaso: Frashëri, Mid'hat, *vep. e përm.*, f. 204; Malcolm, Noel, *vep. e përm.*, f. 202.

“Fshatrat e Rekës të cilët kanë qenë në kontakt me katundet bullgare, e kanë ditur mirë edhe gjuhën bullgare”³². Në kazanë e Dibrës rreth 20.000 banorë ishin shqiptarë ortodoksë³³. Deri në vitet 60 të shek. XIX, popullsia e Rekës fliste vetëm shqip, por më vonë ajo humbi gjuhën amtare dhe u asimilua. Gjithashtu edhe popullsia shqiptare ortodokse e Gostivarit u “bullgarizua në kontakt me bullgarët”³⁴, kurse më vonë u serbizua.

Në Strazimir (krahina e Rekës) më shumë se gjysma e banorëve ishin ortodoksë, por midis tyre flisnin në shqip edhe pas pushtimit serb. Gjithashtu popullsia e Sencës fliste gjuhën shqipe. Në fshatin Zhuzhnjë popullsia ishte e ndarë në dy besime fetare. Si myslimanët ashtu dhe të krishterët flisnin shqip.³⁵ Në vitin 1900, fshatrat Orkushë, Duf, Novishtë, Viban, Zhuzhnjë, Grekë, Ribnicë, Tanushë, Nistrovë, Niçpur, Bogdevë, Vërban, Sencë, Volkovi, Beliçicë, Kiçinicë, Brodec ishin të banuar tërësisht nga popullsia shqiptare, e cila u takonte dy besimeve fetare myslimane dhe ortodokse³⁶. Shumë zakone të popullsisë së Rekës ishin të njëjta me ato të Shqipërisë. Në varësi të kishës të cilës i takonte popullsia ortodokse, ajo identifikoj si e tillë edhe në aspektin etnik. Në Niçpur (Rekë), deri në vitin 1903, popullsia ortodokse ishte e lidhur me kishën bullgare, kurse pas atij viti u lidh me Patrikanën e Pejës. Fillimisht ata njiheshin si bullgarë, por më vonë do të njihen si serbë³⁷. Pra, identiteti kombëtar i ortodoksëve ndryshonte varësisht përkatësisë së tyre kishtarë.

Në Vilajetin e Kosovës, një pjesë e popullsisë e klasifikuar si serbe dhe bullgare, d.m.th. si ortodoksë, patriarkistë dhe ekzarkistë, ishte me përkatësi etnike shqiptare, por që padrejtësisht regjistrohej si popullsi sllave, respektivisht serbe ose bullgare. Në qytetin e Tetovës “...një pjesë e banorëve ortodoksë... në vatrën e tyre kanë në përdorim vetëm gjuhën shqipe”. Fshatrat e Zharonicës (Zhironicës), Negotinës, Jellovcës së

³² Pançev, Anton. 2014. Shqiptarët e Rekës në fillim të shekullit XX sipas burimeve bullgare. Në *Shqiptarët e Rekës së Epërme*. Gostivar-Shkup: UEJL, f. 51.

³³ Frashëri, Sami. 2002. *Vepra 3- Viset shqiptare në Kâmus al-A'lâm*. Shkup: Logos-A, f. 55.

³⁴ Mustafâ, Avzi. 2014. Anastas Albanski (Arnaudov) mësues nga Reka e Epërme. Në *Shqiptarët e Rekës së Epërme*. Gostivar-Shkup: UEJL, f. 67.

³⁵ Дода, Бајазид & Барон Нопча, Франц. 2001. *Селскиот живот во Горна Река кај Дебар*. Тетово: Тринга Дизајн, с. 15, 18, 19.

³⁶ Lita, Qerim. 2014. Shqiptarët ortodoksë në Rekë të Epërme dhe shkombëtarizimi i tyre gjatë shekullit XX. Në *Shqiptarët e Rekës së Epërme*. Gostivar-Shkup: UEJL, f. 296-297.

³⁷ Дода, Бајазид & Барон Нопча, Франц, *вер. e përм.*, с. 35-45, с. 16.

Epërme, Jellovcës së Poshtme dhe Dufit banoreshin nga shqiptarët ortodoksë³⁸.

Më 14 nëntor 1907, gazeta “*Daşamiri*”, e cila botohej në Trieste, në një artikull të sajën theksonte se në Kosovë kishte shumë fshatra të banuar nga popullsia shqiptare ortodokse, por se Serbia dhe Bullgaria nëpërmjet kishave të tyre përpiqeshin t’i asimilonin³⁹. Prandaj, kërkoheshin nga qeveria e Stambollit hapjen e shkollave në gjuhën shqipe, për ta penguar këtë proces asimilimi.

Pas triumfit të revolucionit xhonturk, shkollë shqipe u hap në fshatin Nistrovë, të Rekës. Veprimtari i njohur i Rilindjes sonë Kombëtare, Josif Bageri, i gëzuar për çeljen e shkollës në fshatin e tij të lindjes, i dhuroi shkollës së re 20 abetare⁴⁰. Megjithatë, hapja e kësaj shkolle jo vetëm që ishte e vonuar, por sapo xhonturqit i forcuan pozitat në pushtet, filluan luftën kundër shkollave shqipe, duke u krijuar kështu terren të përshtatshëm propagandave të vendeve fqinje për të realizuar me sukses synimet e tyre asimiluese në territoret shqiptare.

Hapja e shkollave fetare pengonte zhvillimin e ndërgjegjes kombëtare te fëmijët dhe të rinjtë shqiptarë, pasi shkollat osmane dhe të tjera të huaja u shërbenin propagandave të shteteve, nga të cilët financoheshin ato. Si shkollat myslimane ashtu edhe ato që financoheshin nga shtetet fqinje kishin për qëllim asimilimin e shqiptarëve. Porta e Lartë, nëpërmjet shkollave fetare dhe arsimit në gjuhën osmane, synonte që shqiptarët myslimanë t’i shndërronte në osmanlinj. Qëllime të njëjta kishin edhe shtetet fqinje si Greqia, Serbia dhe Bullgaria, të cilat nëpërmjet shkollave dhe kishave synonin asimilimin e shqiptarëve ortodoksë. Një pjesë e mirë e këtyre të fundit, si pasojë e shkollës dhe e kishës, e kishin humbur identitetin e tyre kombëtar dhe të njëjtin rrezikonin ta humbnin edhe një pjesë tjetër. Shqiptarët e krishterë të Rekës refuzuan të mësonin serbisht, greqisht, apo bullgarisht. Ata kërkonin të mësonin në gjuhën shqipe⁴¹. Të revoltuar nga kjo politikë e mohimit të arsimit në gjuhën amtare, më 27 janar 1912, banorët e nëntë fshatrave të krahinës së Rekës, i dërgonin një letër sulltanit, nëpërmjet së cilës kërkonin nga ai që t’u mundësonte zhvillimin e meshës në gjuhën shqipe dhe anga-

³⁸ Frashëri, Mid’hat, *vep. e përm.*, f. 183, 190, 191, 204.

³⁹ Avdiu, Shpend. 2021. *Gazeta “Daşamiri” – “Daşamiri i ri” 1907-1908*. Prishtinë: Instituti Albanologjik, f. 53. Shih referencën 100.

⁴⁰ Kraja, Musa. 1993. *Mësuesit për kombin shqiptar*. Tiranë: Toena, f. 145.

⁴¹ Popovski, Vllado. 2012. *Lëvizja Kombëtare Çlirimtare Shqiptare (1830-1912)*. Tetovë: ArbëriaDesign, f. 188-189.

zhimin e mësuesve shqiptarë në shkollat e tyre. “*Shqiptarët ortodoks të Rekës [...]*” i njoftonin autoritetet osmane se “*këtej e tutje nuk do ta njohin klerin grekë si kryesi të kishës*”. Ata kishin njoftuar qeverinë osmane se nuk do të pranonin as priftërinj dhe as mësues të huaj, sepse “*ne nuk jemi as grekë, as serbë e as bullgarë*”. Nëse kërkesa e tyre nuk do të realizohej, ata kërcënonin se do të detyroheshin të kërkonin mbrojtjen e Selisë së Shenjtë⁴². Ata shpresonin se duke kaluar nën mbrojtjen e Vatikanit, meshën dhe shkollën do të kishin mundësi t’i zhvillonin në gjuhën shqipe, ashtu siç ndodhte në shkollat katolike që ishin nën mbrojtjen e Austro-Hungarisë.

Presioni i vazhdueshëm nëpërmjet kishës dhe shkollës e detyronte popullsinë shqiptare ortodokse të pranonte fenë islame. Nëpërmjet konvertimit ata arrinin të siguronin mbrojtjen e autoriteteve osmane. Shumica e popullsisë së fshatit Ribnicë fillimisht kishte qenë ortodokse, por më vonë pjesa më e madhe ishte islamizuar⁴³. Përpjekjet e vazhdueshme nëpërmjet kishës dhe shkollës për ta sllavizuar këtë popullsi e detyroi atë të braktiste fenë e vet dhe të kalonte në islam.

Popullsia e Zhironicës u takonte dy besimeve fetare, ortodokse dhe myslimane. Të krishterët, pas pushtimit serb në vitin 1912 filluan të flasin sllavisht kurse myslimanët e ruajtën gjuhën shqipe, megjithëse “*të gjithë e kuptojnë gjuhën shqipe*”. Ky fshat ishte edhe qendër e nahijes së Zhironicës⁴⁴. Popullsia e këtij fshati kishte qenë shqiptare, por pjesa e krishterë, si pasojë e presionit të vazhdueshëm që kishte kryer kisha, shkolla dhe pastaj edhe organet shtetërore pas pushtimit, u sllavizua.

Në Ohër kishte 150 shtëpi të shqiptarëve ortodoksë dhe disa të tjera ishin të shqiptarëve të greqizuar. Sipas shifrave të autoriteteve osmane, të nxjerra gjatë ditëve të fundit të sundimit të tyre, 38.000 banorë ishin shqiptarë dhe 36.500 joshqiptarë. Brenda këtyre të fundit përfshiheshin edhe shqiptarët ortodoksë, të cilët njihnin ekzarkatin, por osmanët në regjistrat e tyre i llogarisnin ata si bullgarë. Shqiptarët ortodoksë të Ohrit, në mungesë të kishës së tyre kombëtare, ishin të detyruar të ndiqnin kishën bullgare, prandaj në statistikat osmane padrejtësisht evidentoheshin si sllavë. Disa shqiptarë që jetonin më në jug të Ohrit ishin të lidhur me kishën greke dhe konsideroheshin grekë. Por, nga-

⁴² *AIH*, Vj. 22- 20- 2039. Relacion i shqiptarëve ortodoksë të Rekës drejtuar autoriteteve osmane. Zharmonicë (Rekë), më 27 janar 1912.

⁴³ Дода, Бајазид & Барон Нопча, Франц *vep. e përm.*, с. 19.

⁴⁴ *Po aty*, с. 18.

njëherë vetë grekët i quanin *alvanophono* (d.m.th. grekë që flasin shqip). Sllavët kanë qenë të prirë që t'i evidentojnë shqiptarët ortodoksë, në Ohër, në Manastir, në Prishtinë, apo Pejë si sllavë⁴⁵.

Nën ndikimin e kishës, klerit dhe të shkollës, të krishterët e Tetovës dhe të Pejës janë konsideruar shpesh sllavë. Në statistikat e tyre, serbët dhe bullgarët nuk regjistronin shqiptarë të tjerë, përveç atyre që praktikonin fenë myslimane ose katolike, kurse ortodoksët i cilësonin përgjithësisht si serbë ose bullgarë. Ortodoksët e Tetovës, nën ndikimin e kishës dhe të shkollës, kishin mësuar të flasin sllavisht. Në sanxhaqet e Prizrenit, të Pejës, të Prishtinës dhe në anët veriore e perëndimore të sanxhakut së Shkupit ortodoksët shqiptarë ishin sllavizuar me anë të shkollës e të kishës⁴⁶. Në një fshat të fushës së Shkupit, të banuar nga popullsia e krishterë, kur shërbesat fetare i kryente një prift ortodoks, flitej dialekti shqiptar. Ndikimi i kishës kishte bërë që ata të humbnin ndër-gjegjen kombëtare. Nëse u kërkohet atyre të deklaroheshin për përkatësinë e tyre etnike, përgjigjja ishte: “*Ne jemi bullgarë*”⁴⁷, pavarësisht se me njëri-tjetrin komunikonin në gjuhën shqipe.

Sipas një statistike bullgare të vitit 1900, kazaja e Rekës numëronte 6.959 shqiptarë, 12.015 bullgarë (ortodoksë) dhe 6.505 bullgarë myslimanë. Sipas këtyre të dhënave, mbi 3.600 ishin shqiptarë myslimanë (18%) dhe mbi 2.400 shqiptarë ortodoksë ose 12%, kurse 13.700 ishin sllavë. Por, një statistikë e vitit 1914 jep të dhëna krejtësisht të ndryshme nga ato bullgare. Sipas tyre, shqiptarët përbënin shumicën absolute të popullsisë në atë kaza. Nga 17.700 banorë, sa kishte ajo krahinë 17.000 ose 96% ishin shqiptarë, kurse 700 ose 3.59% ishin bullgarë⁴⁸.

Nga fundi i shek. XIX në Strugë, Prespë, Dibër, Gostivar, Krushëvë, Manastir, jetonin edhe shqiptarë ortodoksë. Por, identiteti i tyre kombëtar ndryshoi shpejt pas Luftërave Ballkanike. “*Shqiptarët ortodoksë dhe ortodoksët tjerë në Ballkan, pasi ortodoksizmi shihej si fe e sllavëve, llogariteshin sllavë, kurse ata që ishin më në jug llogariteshin grekë*”⁴⁹. Në periudhën e mëvonshme ortodoksët shqiptarë të viseve të

⁴⁵ Frashëri, Mid'hat, *vep. e përm.*, f. 193, 195, 226.

⁴⁶ Frashëri, Sami, *vep. e përm.*, f. 129, 204, 207, 260.

⁴⁷ Frashëri, Mid'hat, *vep. e përm.*, f. 238.

⁴⁸ Bartl, Peter, *vep. e përm.*, f. 82.

⁴⁹ Nesimi, Qani. 2014. Ortodoksët shqiptarë të Rekës së Epërme viktimë e nacionalizmit të kishës ortodokse. Në *Shqiptarët e Rekës së Epërme*. Gostivar-Shkup: UEJL, f. 287-288.

pushtuara nga Serbia filluan të trajtohen si ortodoksë sllavë dhe kështu ata u asimiluan, duke humbur identitetin kombëtar.

Evidentimi i popullsisë së Vilajetit të Kosovës në fund të shek. XIX dhe në fillim të atij XX paraqet vështirësi jo vetëm për faktin se regjistrimet osmane të popullsisë vijonin të ishin jo të plota, por edhe për shkak të zgjerimit në atë periudhë, të ndërhyrjes së shteteve fqinje ballkanike dhe të Fuqive të Mëdha në pjesën evropiane të Perandorisë Osmane, e në veçanti në “*çështjen maqedonase*”. Në atë periudhë u botuan statistika të ndryshme demografike, shpeshherë të falsifikuara për popullsinë e pjesës evropiane të shtetit osman. Shqiptarët ortodoksë evidentoheshin vetëm si patriarkistë ose ekzarkistë. Në statistikat e kohës ata shënoheshin “*rum millet*” ose “*të krishterë*” dhe si të tillë konsideroheshin serbë ose bullgarë-maqedonas⁵⁰.

Në shërbim të politikës shtetërore të Beogradit u vunë edhe studiues serbë. Qëndrimi zyrtar i serbëve kundrejt shqiptarëve ishte: shqiptarët myslimanë duhej ta ndanin fatin me Perandorinë Osmane, që nënkuptonte se me largimin e pushtetit osman edhe ata duhej të largoheshin bashkë me osmanët për në territoret e Perandorisë Osmane, kurse ata pak shqiptarë myslimanë që do të mbeteshin, bashkë me shqiptarët ortodoksë dhe katolikë dhunshëm do të konvertoheshin dhe do të asimiloheshin, pra do ta ndërronin fenë dhe kombin⁵¹.

Për autorët serbë, çdo gjurmë e mbetur e praktikës së fesë popullore me prejardhje ortodokse, ndër shqiptarët e Kosovës, përbënte provë të mjaftueshme se shqiptarët kanë prejardhjen sllave ortodokse. Kështu, kulti i shenjtoreve popullorë, Shën Gjergji ose Shën Nikolla, apo celebrimi i ditës së shenjtit mbrojtës të familjes ose kremtimi i buzmit natën e Krishtlindjeve ishin “*argumente*” të mjaftueshme për ata që t’i quanin shqiptarët sllavë “*të vërtetë*”. Në fakt para se të pranonin islamin, të parët e shqiptarëve ishin të krishterë: katolikë e ortodoksë. Prandaj, kremtimi i një dite të shenjtë ortodoks ose i praktikave të tjera fetare ortodokse, nuk nënkupton domosdo edhe përkatësinë etnike serbe. Madje disa nga këto festa kishin zanafillë pagane (kremtimi i buzmit)⁵².

Megjithatë, ka pasur raste kur edhe studiues sllavë (bullgarë) kanë pranuar ekzistencën e shqiptarëve ortodoksë, në territoret shqiptare lin-

⁵⁰ Prifti, Kristaq. 2014. *Popullsia e Kosovës 1831-1912*. Tiranë: ASHSH, f. 721, 711-718, 890- 892, 894-896.

⁵¹ Buzhala, Rustem. 2011. *Shqiptarët në Turqi*. Prishtinë: Instituti Albanologjik, f. 16-17.

⁵² Shih: Malcolm, Noel, *vep. e përm.*, f. 205-206.

dore dhe verilindore. Studiuesi bullgar, Vasil Kënçov thekson se në qytetin e Ohrit jetonin 300 shqiptarë të krishterë. Sipas të dhënave që ofron ai në fund të shek. XIX, të gjitha vendbanimet e Rekës së Epërme, ose siç njihet ndryshe Reka e Madhe ishte e banuar tërësisht nga popullsia shqiptare. Kicinica, Beliçica, Vullkavia, Senca, Vërbjan, Tërnica, Bogdeva, Niçpuri, Brodeci, Nivishta, Bibaj, Zhuzhnja, Grekani, Ribnica, Strezimiri, Shtirovica, Tanushaj, Dëbova, Nistrova, Krokornica etj., ishin vendbanime tërësisht shqiptare. Popullsia u takonte dy besimeve fetare: myslimane dhe ortodokse. Nga 6.959 banorë sa kishin gjithsej këto fshatra, 3.221 ishin ortodoksë shqiptarë, kurse 3.738 të tjerë myslimanë. I njëjti autor ofron të dhëna për popullsinë e Kazasë së Tetovës. Megjithëse shumicën dërrmuese të popullsisë së krishterë e konsideron bullgare, ai pranon se në atë kaza jetonin edhe 874 shqiptarë të krishterë. Gjithashtu ai pranon se në Kazanë e Manastirit jetonin vetëm 650 shqiptarë të krishterë⁵³.

Gazeta e Sofjes, “*Jehona e Bullgarisë*”, në njërin prej numrave të saj, në vitin e parë të botimit (1913), në një studim që i kishte kushtuar Dibrës, pranon se “*nën influencën e propagandës aktive të bullgarëve, jo vetëm sllavët e Dibrës, por edhe shqiptarët e krishterë kanë filluar të quhen bullgarë*”. Studiuesi bullgar, Jordan Ivanov (Йордан Иванов), theksonte se “*në Gostivar, popullsia shqiptare e krishterë që jeton pranë minoritetit bullgar, është bullgarizuar*”⁵⁴.

Organizimi fetar i sllavëve, i ngjashëm me atë që kanë pasur grekët deri në fund të shek. XIX, u krijoi atyre shumë përparësi kundrejt shqiptarëve. Shqiptarët ortodoksë, të detyruar të frekuentojnë kishat dhe shkollat sllave, serbe ose bullgare, shumë shpesh u njësuan si të tillë dhe numri i tyre ka shërbyer për të rritur atë të sllavëve. Për këtë arsye udhëtarët dhe etnografët e ndryshëm kanë parë në veri dhe verilindje të Shqipërisë veç shqiptarë myslimanë dhe katolikë, ndërsa ortodoksët i kanë ngatërruar me sllavët. Propaganda ngulmuese nëpërmjet shkollës dhe kishës ka krijuar një iluzion të gabuar të gjendjes etnografike, ose për të ndryshuar karakterin etnik. Gazeta e Sofjes “*Jehona e Bullgarisë*” (Ехо на България, 1913), shkruante: “*Meqenëse qendër e vetme bullgare e dijes në rajon, manastiri i Shën Zhan Bigorit...*”, kishte arritur jo

⁵³ Кънчов, Васил. 1970. *Македония. Етнография и статистика*. Софиа: Издателство Наука и Искуство, с. 253-255, 564, 211-215, 237-244.

⁵⁴ Иванов, Йордан. 1915. *Българите в Македония*. Софиа, с. LXIII. (Cituar sipas: Frashëri, Mid’hat, *ver. e përm.*, f. 204).

vetëm të ruante gjuhën dhe shërbimin fetar bullgar në fshatrat e pastra bullgare, duke iu referuar këtyre mësuesve shkollash, famullitarë, psaltë dhe ikonograf, “*por ka arritur të ushtroj një influencë mbi popullsinë e pastër shqiptare të kësaj krahine, aq sa shqiptarët ortodoksë të krahinës së Rekës së Epërme e bëjnë shërbesën fetare, si në të kaluarën ashtu edhe sot, në gjuhën sllavo-bullgare...*”⁵⁵.

Përballë kësaj politike asimiluese të qeverisë serbe dhe të asaj bullgare, drejtuesit e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare i drejtuan kërkesa të vazhdueshme Portës së Lartë, nga e cila kërkonin lejimin e përdorimit të gjuhës shqipe në shkollat ekzistuese në territoret shqiptare dhe hapjen e shkollave të reja. Një kërkesë tjetër e vazhdueshme e tyre ishte shkëputja e komunitetit fetar ortodoks shqiptar nga Patrikana e Stambollit dhe themelimi i një Kise Autoqefale Shqiptare. Ata ishin të vetëdijshëm se vetëm kështu do të mund t’i bënin ballë politikës asimiluese të shteteve fqinje. Njëri ndër ideologët më të shquar të Lëvizjes Kombëtare, Abdyl Frashëri kundërshtonte botimet në gjuhët e huaja, sllave dhe greke, në territoret shqiptare dhe mungesën e botimeve shqipe. Ai gjithashtu kërkonte nga qeveria osmane që në vend të shkollave të huaja, të lejonte hapjen e shkollave shqipe. Sipas tij, fqinjët kishin për qëllim të fusnin përçarjet midis shqiptarëve dhe se me politikën e saj qeveria osmane i ndihmonte ato në këtë drejtim⁵⁶.

Në korrik të vitit 1896, një Komitet Shqiptar i Reformave i dërgoi vezirit të madh një memorandum, në emër të të krishterëve dhe myslimanëve, duke protestuar kundër politikës zyrtare osmane e cila shqiptarët ortodoksë i konsideronte grekë ose sllavë, varësisht vendit ku ata jetonin, në jug ose në veri. Në këtë mënyrë, numri i shqiptarëve zvogëlohej për llogari të popujve ortodoksë fqinjë⁵⁷.

Në një mbledhje të mbajtur në Bukuresht, në nëntor 1898, u vendos që t’i dërgohet sulltanit një telegram, me të cilin e lusnin atë “*që të vihet gjuha shqipe në të gjitha shkollat që janë sot në Shqipëri*”⁵⁸. Sami Frashëri kërkonte nga bashkëkombësit e tij që ta ruanin Shqipërinë që të mos copëtohej nga të huajt; të mbronin gjuhën shqipe; të pengonin

⁵⁵ Frashëri, Mid’hat, *vep. e përm.*, f. 225-226.

⁵⁶ Kılıç, Selda. Bir Osmanlı Aydınının Arnavutluk’a Dair Görüş ve Düşünceleri. Në *Ankara Üniversitesi Osmanlı Tarihi Araştırma ve Uygulama Merkezi*, Nr. 19. Ankara, 2006, s. 265.

⁵⁷ Skendi, Stavro, *vep. e përm.*, f. 166.

⁵⁸ *AIH*, A-IV-154, Timo Dilo, Shqipëria në vitet e fundit të shek. XIX, Kap. XVI-1229-C, f. 33.

përhapjen e propagandës greke dhe sllave; të mbroheshin nga priftërinjtë grekë, serbë e bullgarë; kërkonte mëvetësimin e kishës ortodokse shqiptare dhe përcaktimin e kufijve të Shqipërisë, të cilët do të duhej të njëheshin nga Evropa⁵⁹.

Me një memorandum të vitit 1899, që Ibrahim Temo ia dërgonte Stambollit kërkonte shkolla fillore në gjuhën shqipe. Ai kritikonte politikën qeveritare, e cila kishte bërë që shqiptarët e krishterë të regjistroheshin si bullgarë, serbë, ose grekë, çka sipas tij u lejonte vendeve fqinje të pohonin se ato përfaqësonin shumicën e popullsisë në Turqinë evropiane. Prandaj, ai kërkonte përdorimin e termave ortodoks dhe katolik për të treguar përkatësinë fetare, futjen e gjuhës shqipe në kisha dhe hapjen e shkollave shqipe, ku nxënësit të mësonin gjithashtu edhe turqishten⁶⁰.

Më 27 maj të vitit 1900, shoqëria “Drita” në Bukuresht mbajti mbledhje, në të cilën miratoi një rezolutë, e cila përmbante këto kërkesa: pavarësimin e kishës ortodokse shqiptare nga Patrikana greke e Stambollit dhe zgjedhjen e një patriarku shqiptar në krye të saj; kleri të ishte i gjithi shqiptar dhe në kishë të mësohej vetëm shqip; 4 vilajetet e Shqipërisë të udhëhiqeshin nga një vali dhe shqipja, krahas osmanishtes të ishte gjuhë zyrtare; të hapeshin shkolla në gjuhën shqipe dhe shpenzimet e tyre të mbulohehin nga taksat që mblidhte qeveria nga popullsia e atyre territoreve; në pasaportë të mos viheshin fe greke, fe sllave ose indikacione të tjera, por vetëm “i krishterë shqiptar”⁶¹.

Megjithëse shqiptarët në vazhdimësi kërkonin nga Porta e Lartë që të njëjtte kombin shqiptar, pavarësisht dallimeve fetare, të lejonte hapjen e shkollave dhe të botimeve në gjuhën shqipe, qeveria osmane jo vetëm që nuk plotësonte asnjë kërkesë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, por përkundrazi vazhdonte t’u bënte lëshime fqinjëve ballkanikë në territoret shqiptare. Të zhgënjyer nga qëndrimi neglizhues dhe refuzues i shtetit osman, shqiptarët do t’u drejtohen për ndihmë Fuqive të Mëdha të kohës. Në shtator të vitit 1903, Agap pasha, Hysen pasha, Myrteza pasha, Sulejman pasha, Ali Draga pashazade, Nexhip beu, Jusuf aga, Zenel beu dhe të tjerë krerë shqiptarë i dërguan një letër konsullit anglez në Shkup,

⁵⁹ *Po aty*, f. 39.

⁶⁰ Clayer, Nathalie. 2009. *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar- Lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë*. Tiranë: Marin Barleti, f. 349.

⁶¹ *AIH*, A-IV-154, Timo Dilo, Shqipëria në vitet e fundit të shek. XIX, Kap. XVI-1229-C, f. 53, 54.

Mr. Fontanes, me anë të së cilës i kërkonin ndihmë Anglisë kundër rrezikut sllav që po forcohej në Maqedoni në dëm të shqiptarëve⁶².

Në vjeshtën e vitit 1908, “Albania” e Faik Konicës kishte botuar një program ku artikulohehin kërkesat kombëtare shqiptare në emër të “komiteteve shqiptare”. Këto kërkesa do t’i drejtohehin qeverisë në Stamboll, aprovimi i të cilave do të çonte në krijimin e një shteti autonom shqiptar. Njëra ndër këto kërkesa ishte ajo për “Autonominë e Kishës Ortodokse Shqiptare”, e cila konsiderohej si jetike për të shpëtuar komunitetin shqiptar ortodoks nga kthetrat e fqinjëve. Krerët kombëtarë deklaroheshin kundër dallimeve fetare dhe kërkonin barazinë e të gjithë shtetasve, pavarësisht përkatësisë religjioze përpara ligjit, ose siç thuhej në program “përpara një qeverie krejtësisht laike”. Në program shprehej vendosmëria e shqiptarëve për mbrojtjen e territoreve të tyre nga synimet “uzurpuese” të popujve të tjerë, sidomos “intrigave sllave dhe helenike”. Hartuesit e programit shpreheshin se pavarësisht besimit fetar të cilit i takonin, ata nuk ndjeheshin “as grekë, as bullgarë, as turq”, por “vetëm nacionalistë shqiptarë”. Hartues të programit ishin disa klube shqiptare të kohës, si: Komiteti Shqiptar i Konstancës (Rumani), Grupi i Rinisë Ortodokse etj.⁶³

Në fillim të vitit 1909, shoqëria “Lidhja Ortodokse shqiptare nde Korçë” kërkonte nga Patrikana e Stambollit që t’u njëhte ortodoksëve shqiptarë të drejtën e kryerjes së shërbimeve fetare në gjuhën shqipe⁶⁴. Në një artikull të botuar nga gazeta “Lidhja Ortodokse”, me titull “Ortodokset Shqiptare”, akuzohej kisha se në emër të Krishtit vriste klerikë dhe anatemonte besimtarë ortodoksë shqiptarë, të cilët nuk i nënshtroheshin politikës asimiluese të kishës⁶⁵. Gazeta falënderonte Sinodin Ortodoks të Rusisë, që kishte bërë të mundur shugurimin e Nolit prift dhe shkëputjen e Kishës Ortodokse Shqiptare* nga varësia e Patrikanës së Stambollit⁶⁶.

⁶² Bozborra, Nuray. 2002. *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane*. Tiranë: Dituria, f. 223.

⁶³ *AIH*, Vj. 18-4-415. Raport nr. 119 nga Shkodra për Vjenën. Shkodër, më 2 nëntor 1908.

⁶⁴ “Lirija”, nr. 29, e shtune, 1 shkurt, Selanik, 1909, f. 2. (Cituar sipas: Ahmeti, Nuridin. 2014. Gazeta “Lidhja Ortodokse” për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Në *Gjurmime Albanologjike*, Nr. 44. Prishtinë: Instituti Albanologjik, f. 130-131).

⁶⁵ “Lidhja Ortodokse”, nr. 1, 10 korrik, Korçë 1909, f. 1. (Cituar sipas: Ahmeti, Nuridin, *art. i përm.*, f. 134).

* Më 8 mars 1908, Fan Noli shugurohet meshtar nga argjipeshkvi rus i Nju Jorkut, kurse më 22 mars ai mbajti meshën e tij të parë në gjuhën shqipe (Shih: Avdiu, Shpend.

Presioni i vazhdueshëm i shteteve fqinje për asimilimin e shqiptarëve ortodoksë bëri që brenda këtij komuniteti fetar të përhapej ideja e konvertimit të tyre në unitë ose protestantë. Gazeta “Kombi”, që botohej në Boston, propozonte konvertimin e shqiptarëve në unitë, pra të ruhej liturgjia ortodokse, por papa të njihej udhëheqës shpirtëror suprem. Shoqëria shqiptare e Egjiptit propozonte kalimin e shqiptarëve në protestantë⁶⁷. Në këtë çështje ishin përfshirë edhe diplomatët austro-hungarezë, të cilët shërbenin në territoret shqiptare. Konsulli austro-hungarez në Shkodër, T. Ippen, kishte ndihmuar në themelimin e një kisha unite në Elbasan, megjithëse numri i anëtarëve të saj ishte vetëm 80. Sipas tij, arsyeja e vërtetë pse ortodoksët kërkonin të lidheshin me kishën katolike, nuk ishte dashuria e tyre për Austro-Hungarinë, por neveria që kishin të krishterët ortodoksë shqiptarë për tendencat helenizuese të Patrikanës Ekumenike⁶⁸ dhe të kishës serbe dhe bullgare.

Politika e konvertimit të dhunshëm të shqiptarëve në fenë ortodokse vazhdoi pas pushtimit të territoreve të tyre nga Serbia dhe Mali i Zi, gjatë Luftës së Parë Ballkanike (1912-1913). Madje konvertimit të detyrueshëm nuk i shpëtuan as katolikët dhe në disa raste edhe myslimanët. Kundër katolikëve në zonën e pushtuar nga malazeztë ushtrohej presion i veçantë mbi popullsinë shqiptare për t’i konvertuar dhunshëm në fenë ortodokse. Një prift katolik në Gjakovë, frat Luigj Palaj, pasi refuzoi të bënte kryqin sipas ritit ortodoks, u masakrua nga ushtarët. Nga fundi i marsit 1913, argjipeshkvi Mjeda ankohej se mbi 1.200 besimtarë katolikë ishin konvertuar dhunshëm në fenë ortodokse. Në maj të vitit 1913, komandanti i zonës së Prishtinës e njoftonte Beogradin se 195 shqiptarë myslimanë ishin konvertuar në Prishtinë dhe se do të bëhej presion mbi katolikët e Janjevës të konvertoheshin në ortodoksë⁶⁹.

Më 2 janar 1913, përfaqësuesit e fshatrave ortodokse shqiptare të Rekës së Epërme, i dërguan një letër Eduard Grejtit, me të cilën “...konfirmonin përkatësinë e tyre etnike shqiptare dhe denonconin shtypjen e

2021. *Gazeta “Dašamiri” – “Dašamiri i ri” 1907-1908*. Prishtinë: Instituti Albanologjik, f. 81).

⁶⁶ “Lidhja Orthodokse”, nr. 2, 31 korrik, Korçë 1909, f. 1. (Cituar sipas: Ahmeti, Nuredin, *art. i përm.*, f. 134).

⁶⁷ Skendi, Stavro, *vep. e përm.*, f. 169.

⁶⁸ *Po aty*, f. 272.

⁶⁹ Malcolm, Noel, *vep. e përm.*, f. 266.

*egër nga autoritetet serbe*⁷⁰. Ata shpresonin në ndërhyrjen e Britanisë së Madhe pranë qeverisë serbe për ta penguar fushatën asimiluese.

Më 18 shkurt 1913, nënkonsulli Peckham i dërgonte nga Shkupi një relacion Ralph Paget, në të cilin nënvijëzonte se “*shovinizmi, racizmi dhe mostoleranca fetare ishin bazë e keqe për pajtimin e popullit të pushtuar*”. Ai e përshkruante qëndrimin e serbëve ndaj katolikëve si shumë të vrazhdë, të cilët konsideroheshin nga serbët si “*Shvabs*” (austriakë). Në fshatrat ku jetonin kriptokrishterët kishte filluar procesi i konvertimit të dhunshëm në fenë ortodokse. Sipas serbëve “*nëse donë të mbetesh i krishterë, duhet të bëhesh ortodoks*”. Kështu kishte ndodhur me banorët e pesë-gjashtë fshatrave të Gjilanit, të cilët 20 vjet më parë kishin pranuar islamin⁷¹ dhe tani nën pushtetin e ri të krishterë, duhej të ktheheshin në të krishterë, por tanimë jo katolikë, por në ortodoksë.

Mjet mjaft i rëndësishëm për shtrirjen e propagandës së shteteve fqinje ishte shkolla. Në territoret shqiptare ishin hapur shkolla serbe, greke dhe bullgare me lejen e Portës së Lartë. Me këto veprime të qeverisë osmane mbështetje politika pushtuese e shteteve fqinje në dëm të shqiptarëve, në kohën kur ajo vononte me të gjitha mjetet hapjen e shkollave publike në gjuhën shqipe. Në mungesë të shkollave kombëtare, fëmijë shqiptarë, ishin detyruar të ndiqnin mësimet në shkollat serbe e greke. Frekuentimi i këtyre shkollave kishte çuar në serbizimin dhe greqizimin e tyre, madje nga kjo nuk përjashtoheshin as ata myslimanë⁷².

Në rol të rëndësishëm në zhvillimin e propagandës së huaj në territoret shqiptare kishte qeveria osmane. Sulltani nuk i pranonte kërkesat që vinin nga popullsia myslimane dhe ortodokse shqiptare për hapjen e shkollave kombëtare. Me këtë qëndrim sulltani nuk dëshironte t'i hapte rrugë asnjë akti nacionalist që do të godiste unitetin në mes shtetasve myslimanë të perandorisë⁷³. Ai i konsideronte të gjithë myslimanët pjesë të milletit osmanlinj, prandaj pengonte me çdo kusht zhvillimin kombëtar të tyre. Në funksion të kësaj politike ai pengonte edhe shqiptarët ortodoksë që të arsimoheshin në gjuhën amtare, pasi kishte frikë se

⁷⁰ Ajdini, Ejup. 2014. Sfidat për shpëtimin e identitetit kombëtar të shqiptarëve ortodoksë në Maqedoni. Në *Shqiptarët e Rekës së Epërme*. Gostivar-Shkup: UEJL, f. 94.

⁷¹ Rizaj, Gazmend. 2011. *Shqipëria e Sipërme 1800-1913*. Prishtinë: Instituti Albanologjik, f. 529.

⁷² *Haus Hof und Staats Archives*, Wien. Memorandum i Komitetit Qendror Shqiptar për Kostandinopojë për ministrin e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë Kostandinopojë, më 28 korrik 1912.

⁷³ Nuray Bozbor, *vep. e përm.*, f. 196.

vetëdijesimi i tyre kombëtar do të ndikonte edhe mbi bashkëkombësit e tyre mysliman, me çka do të dëmtonte uniteti osman. Gjithashtu, shtetet fqinje ishin kundërshtarë të pavarësimit kishtar të shqiptarëve ortodoksë, prandaj edhe për të mos acaruar raportet me ato ai nuk lejoi mëvetësimin e Kishës Ortodokse Shqiptare, çka i hapi rrugë asimilimit kombëtar të këtij komuniteti fetar.

Shqiptarët ishin i vetmi komb i pjesës ballkanike të Perandorisë Osmane, të cilit Porta e Lartë i mohonte gjuhën, shkollën, kishën. Të gjithë popujt tjerë nën sundimin e sulltanit kishin shkollat e tyre, të cilat financoheshin nga jashtë. Secila prej tyre ishte qendër e gjallë propagande kombëtare. Të gjithë mbroheshin nga konsullata të ndryshme që kërkonin hapjen e të tjera shkollave duke protestuar kur u bëhej ndonjë ndërhyrje⁷⁴, vetëm shqiptarëve u mungonte një përkrahje e tillë.

Rezyme

Gjatë shek. XIX, Gadishulli Ballkanik u karakterizua nga zhvillimi i lëvizjeve nacionaliste. Këto lëvizje duke qenë edhe në rivalitet me njëra-tjetrën për dominim në territoret që ende ishin pjesë e shtetit osman, u angazhuan për ta rritur sa më shumë numrin e bashkëkombësve të tyre në ato territore. Në statistikat e botuara prej tyre popullsia ortodokse shqiptare paraqitej si serbe, greke, ose bullgare, varësisht se cila qeveri qëndronte pas atyre statistikave.

Qeveria serbe, duke pasur pretendime mbi territoret shqiptare veriore bënte përpjekje të vazhdueshme ta paraqiste në numër sa më të madh pakicën serbe në Kosovë. Popullsia shqiptare ortodokse, pavarësisht gjuhës së folur, prejardhjes, të kaluarës historike etj., konsiderohej serbe. Ky qëndrim favorizohej edhe nga politika që Porta e Lartë zhvillonte në territoret shqiptare. Qeveria osmane duke mbështetur konceptin e milletit, mohonte ekzistencën e kombit shqiptar dhe në këtë kuadër nuk lejonte as hapjen e shkollave në gjuhën shqipe dhe aq më pak themelimin e një Kise Ortodokse Autoqefale Shqiptare. Ky qëndrim i shtetit osman u shfrytëzua nga qeveria serbe për të hapur shkolla e për të themeluar kishat dhe shoqatat e saj kulturore në territoret shqiptare veriore, nëpërmjet të cilave u zhvillua një propagandë e ngjeshur në favor të serbizimit të shqiptarëve ortodoks. Si rezultat i kësaj propagande shumë

⁷⁴ Durham, Edith. 2001. *20 vjet ngatërresa ballkanike*. Tiranë: Argeta-LMG, f. 105-106.

shqiptarë ortodoksë dalëngadalë e humbën identitetin e tyre kombëtar, gjuhën amtare dhe u serbizuan.

Procesi i asimilimit të popullsisë shqiptare vazhdoi edhe pas pushimit serb të territoreve shqiptare lindore dhe verilindore. Ky proces tanimë mori karakter institucional dhe krahas popullsisë ortodokse shqiptare përfshiu edhe një pjesë të popullsisë katolike dhe pjesërisht të asaj myslimane. Për realizimin sa më të shpejt të konvertimit dhe të asimilimit, gjerësisht u përdor edhe dhuna.

Procesi i asimilimit të popullsisë shqiptare ortodokse vazhdoi edhe gjatë shek. XX. Mjaft i theksuar ai ishte në krahinën e Rekës, ku popullsia iu nënshtrua dhunës së vazhdueshme për të hequr dorë nga gjuha amtare dhe identiteti kombëtar.

SERBIAN PRESSURE FOR THE ASSIMILATION OF ORTHODOX ALBANIANS (XIX CENTURY TO 1913)

Summary

During the XIX century, the Balkan Peninsula was characterized by development of nationalist movements. These movements, being in rivalry with one another for dominance over the territories still part of the Ottoman state, were committed to increasing the number of their compatriots in those territories as much as possible. In the statistics published by them, the Orthodox Albanian population was introduced as Serbian, Greek or Bulgarian, depending on which government was behind those statistics.

The Serbian government, having had claims over the northern Albanian territories, made constant efforts to present the Serbian minority in Kosovo in as large numbers as possible. The Orthodox Albanian population, regardless of the language they spoke, their origin, historical past, etc., was considered Serbian. This standpoint was also favored by the policy that the High Porte enforced over the Albanian territories. The Ottoman government, supporting the concept of the millet, denied the existence of the Albanian nation and in this context did not even allow opening of schools in the Albanian language, much

less the establishment of an Albanian Autocephalous Orthodox Church. This policy of the Ottoman state was exploited by the Serbian government to open schools and to establish its churches and cultural associations in the northern Albanian territories, thereby an intense propaganda was conducted in favor of the serbization of the Orthodox Albanians. As a result of this propaganda, many Orthodox Albanians gradually lost their national identity, their mother tongue and got serbicized.

The process of assimilation of the Albanian population had continued even after the Serbian occupation of the eastern and northeastern Albanian territories. This process already took on an institutional character, and in addition to the Albanian Orthodox population, it included a part of the Albanian Catholic population and a part of the Albanian Muslim population. Violence was widely used for purposes of achieving conversion and assimilation of the population as quickly as possible.

The process of assimilation of the Orthodox Albanian population kept continuing during the XX century. It was quite significant in the region of Reka, where the population was subject to continual violence to give up their mother tongue and their national identity.

Burimet dhe literatura

Arkivi i Institutit të Historisë në Tiranë. A-IV-154, Timo Dilo, Shqipëria në vitet e fundit të shek. XIX, Kap. XVI-1229-C;

Arkivi i Institutit të Historisë në Tiranë. Fondi dokumente vjeneze.

Haus Hof und Staats Archives, Wien. Memorandum i Komitetit Qendror Shqiptar për Kostandinopojë për ministrin e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë. Kostandinopojë, më 28 korrik 1912.

Ajdini, Ejup. 2014. Sfidat për shpëtimin e identitetit kombëtar të shqiptarëve ortodoksë në Maqedoni. Në *Shqiptarët e Rekës së Epërme*. Gostivar-Shkup: UEJL;

Ahmeti, Nuridin. 2017. Prizreni i Mitrush Kutelit. Në *Mitrush Kuteli-në 110 vjetorin e lindjes (përmbledhje materialesh)*. Korçë: Universiteti Fan Noli;

- Ahmeti, Nuridin. 2014. Gazeta "Lidhja Orthodoxe" për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Në *Gjurmime Albanologjike*, Nr. 44. Prishtinë: Instituti Albanologjik;
- Avdiu, Shpend. 2021. Gazeta "Daşamiri" – "Daşamiri i ri" 1907-1908. Prishtinë: Instituti Albanologjik;
- Braha, Shaban. 1992. *Gjenocidi serbomadh dhe qëndresa shqiptare (1844-1990)*. Tiranë: Lumi-T;
- Bozborra, Nuray. 2002. *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane*. Tiranë: Dituria;
- Clayer, Nathalie. 2009. *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar- Lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë*. Tiranë: Marin Barleti;
- Дода, Бајазид & Барон Нопча, Франц. 2001. *Селскиот живот во Горна Река кај Дебар*. Тетово: Тринга Дизајн;
- Durham, Edith. 2001. *20 vjet ngatërresa ballkanike*. Tiranë: Argeta-LMG, f. 105-106.
- Durham, Edith. Pa datë. *Shqipëria e Epërme-Një udhëtim në Shqipërinë e veriut të vitit 1908*. Tiran: Botimet IDK.
- Eren, Ismail. 1968. Štamparija Kosovskog Vilajeta u Prištinu (1877-1888). Në *Gjurmime Albanologjike*, nr. 1. Prishtinë;
- Frashëri, Mid'hat. 2018. *Vepra të zgjedhura, 2*. Tiranë: Instituti i Studimeve Historike: Lumo Skëndo;
- Bartl, Peter. 2006. *Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare (1878-1912)*. Tiranë: Dituria;
- Buzhala, Rrustem. 2011. *Shqiptarët në Turqi*. Prishtinë: Instituti Albanologjik;
- Frashëri, Kristo. 2006. *Identiteti kombëtar shqiptar dhe çështje të tjera*. Tiranë: EDISUD Spa;
- Frashëri, Sami. 2002. *Vepra 3- Viset shqiptare në Kâmûs al-A'lâm*. Shkup: Logos-A, f. 55.
- Guy, Nicola. 2012. *Lindja e Shqipërisë*. Tiranë: Pegi;
- Historia e Popullit Shqiptar II*. 2002. Tiranë: Toena;
- Jelavish, Charls dhe Barbara. 2004. *Themelimi i Shteteve Kombëtare të Ballkanit 1804-1920*. Tiranë: Dituria;

Kılıç, Selda. Bir Osmanlı Aydınının Arnavutluk'a Dair Görüş ve Düşünceleri. Në *Ankara Üniversitesi Osmanlı Tarihi Araştırma ve Uygulama Merkezi*, Nr. 19. Ankara, 2006;

Кънчов, Васил. 1970. *Македонија. Етнографија и статистика*. Софија: Издателство Наука и Искуство;

Kraja, Musa. 1993. *Mësuesit për kombin shqiptar*. Tiranë: Toena;

Lita, Qerim. 2014. Shqiptarët ortodoksë në Rekë të Epërme dhe shko-mbëtarizimi i tyre gjatë shekullit XX. Në *Shqiptarët e Rekës së Epërme*. Gostivar-Shkup: UEJL;

Malcolm, Noel. 2001. *Kosova-një histori e shkurtër*. Prishtinë-Tiranë: Koha-Shtëpia e Librit;

Mehmeti, Sadik. 2019. *Shkollat dhe arsimi në Kosovë 1830-1912*. Prishtinë: Instituti Albanologjik;

Mustafa, Avzi. 2014. Anastas Albanski (Arnaudov) mësues nga Reka e Epërme. Në *Shqiptarët e Rekës së Epërme*. Gostivar-Shkup: UEJL, f. 67.

Nesimi, Qani. 2014. Ortodoksët shqiptarë të Rekës së Epërme viktimë e nacionalizmit të kishës ortodokse. Në *Shqiptarët e Rekës së Epërme*. Gostivar-Shkup: UEJL;

Pajaziti, Ali. 2014. Reka e Dytë dhe roli i islamit në apologjinë identitare etnike të shqiptarëve rekas. Në *Shqiptarët e Rekës së Epërme*. Gostivar-Shkup: UEJL.

Pançev, Anton. 2014. Shqiptarët e Rekës në fillim të shekullit XX sipas burimeve bullgare. Në *Shqiptarët e Rekës së Epërme*. Gostivar-Shkup: UEJL, f. 51.

Popovski, Vllado. 2012. *Lëvizja Kombëtare Çlirimtare Shqiptare (1830-1912)*. Tetovë: ArbëriaDesign;

Prifti, Kristaq. 2001. Diversiteti fetar dhe uniteti kombëtar te shqiptarët. Në *Studime Historike*, nr. 1-2. Tiran.

Prifti, Kristaq. 2014. *Popullsia e Kosovës 1831-1912*. Tiranë: ASHSH;

Rahimi, Shukri. 1971. *Rilindja dhe emancipimi kombëtar*. Shkup: Fondi republikan për zhvillimin e veprimtarisë botuese.

Rizaj, Gazmend. 2011. *Shqipëria e Sipërme 1800-1913*. Prishtinë: Instituti Albanologjik;

Roka. Maroco dela. 1994. *Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920-1944*. Tiranë:
A. Z. Çajupi;

Skendi, Stavro. 2000. *Zgjimi kombëtar shqiptar 1878-1912*. PHOENIX &
Shtëpia e librit dhe komunikimit.